

1 Prill 2020

EMA/170590/2020

COVID-19: klorokina dhe hidroksiklorokina të përdoren vetëm në hulumtimet klinike ose programet e përdorimit emergjent

Klorokina dhe hidroksiklorokina, dy barna aktualisht të autorizuar për malarie dhe sëmundje të caktuara autoimune, po hulumtohen në të gjithë botën për potencialin e tyre për të trajtuar sëmundjen koronavirus (COVID-19). Megjithatë, efikasiteti në trajtimin e COVID-19 duhet të tregohet ende në studime.

Është shumë e rëndësishme që pacientët dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor të përdorin klorokinën dhe hidroksiklorokinën vetëm për përdorimet e tyre të autorizuar ose si pjesë e hulumtimeve klinike ose programeve kombëtare të përdorimit emergjent për trajtimin e COVID-19.

Të dyja, klorokina dhe hidroksiklorokina mund të kenë efekte anësore serioze, veçanërisht në doza të larta ose kur kombinohen me barna të tjera. Ato nuk duhet të përdoren pa recetë dhe pa mbikëqyrje të mjekut; recetat nuk duhet të jepen jashtë përdorimeve të tyre të autorizuar, përveç në mjedisin e një hulumtimi klinik ose protokoleve të pranuar nacionale.

Studime të mëdha klinike janë duke u zhvilluar për të gjeneruar të dhëna të fuqishme të nevojshme për të përcaktuar efikasitetin dhe sigurinë e klorokinës dhe hidroksiklorokinës në trajtimin e COVID-19. Agjencia Europiane e Barnave (EMA) mirëpret këto hulumtime, të cilat do t'u japin mundësi autoriteteve të japin këshilla të besueshme të bazuar në evidencë të fortë për profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe pacientët.

Duke marrë parasysh urgjencën dhe presionin me të cilin ballafaqohen sistemet e kujdesit shëndetësor për të shpëtuar jetë gjatë pandemisë COVID-19, disa shtete, përfshirë SHBA-në dhe Francën, kanë vendosur protokole të rrepta për të lejuar përdorimin eksperimental të këtyre dy barnave, për shembull, në pacientët me forma të rënda të COVID-19.

Klorokina dhe hidroksiklorokina janë barna vitale për pacientët me sëmundje autoimune si lupus. Është e rëndësishme që pacientët e tillë të jenë akoma në gjendje t'i marrin ato dhe të mos përballen me mungesa të shkaktuara nga grumbullimi i stoqeve ose nga përdorimi jashtë indikacioneve të autorizuar. Në disa shtete, përshkrimi i barnave është kufizuar për të zvogëluar rrezikun e mungesës.

Informacione për pacientët

- Përdorni klorokinë ose hidroksiklorokinë vetëm nëse ato janë përshkruar për ju dhe mjeku është duke mbikëqyrur trajtimin tuaj.

- Pyesni mjekun ose farmacistin nëse keni ndonjë pyetje lidhur me përdorimin e klorokinës ose hidroksiklorokinës ose ndonjë bari tjetër.

Informacione për profesionistët e kujdesit shëndetësor

- Për COVID-19, klorokina dhe hidroksiklorokina preferohet të përdoret në kontekstin e hulumtimeve klinike. Jashtë hulumtimeve klinike, ato mund të përdoren në përputhje me protokolet e përcaktuara nacionale.
- Klorokina dhe hidroksiklorokina duhet të vazhdojnë të përdoren në gjendjet kronike. Për të parandaluar sforcimin e panevojshëm në zinxhirët e furnizimit, pacientët duhet të marrin vetëm furnizimin e tyre të zakonshëm me barna. Profesionistët e kujdesit shëndetësor nuk duhet të shkruajnë receta që mbulojnë më gjatë se kohëzgjatja e zakonshme.

Marrë nga webfaqja e Agjencisë Europiane të Barnave (EMA):
https://www.ema.europa.eu/en/documents/press-release/covid-19-chloroquine-hydroxychloroquine-only-be-used-clinical-trials-emergency-use-programmes_en.pdf